



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë –Ministarstvo Pravde –Ministry of Justice

UDHËZIM ADMINISTRATIV
NR. 15/2024
PËR PROCEDURËN DISIPLINORE, KLASIFIKIMIN DHE
SHQIPTIMIN E DËNIMEVE DISIPLINORE PËR PERSONAT E
DËNUAR¹

¹ Udhëzim Administrativ Nr. 15/2024 për Procedurën Disiplinore, Klasifikimin dhe shqiptimin e Dënimeve Disiplinore për personat e Dënuar, i nënshkruar nga Ministria e Ministrisë së Drejtësisë me datë: 05.12.2024, me Vendim Nr. 430/2024 të datës 05.12.2024

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 101 (paragrafi 3) të Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr.08/L- 117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 9 (paragrafi 2) të Rregullores (QRK) - Nr.17/2024 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Nxjerrë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV
NR. 15/2024
PËR PROCEDURËN DISIPLINORE, KLASIFIKIMIN DHE SHQIPTIMIN E
DËNIMEVE DISIPLINORE PËR PERSONAT E DËNUAR

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është rregullimi i procedurës disiplinore, klasifikimi dhe shqiptimi i dënimeve disiplinore ndaj personave të dënuar me qëllim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë në institucionet korrektuese.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen për të dënuarit, paraburgosurit si dhe ndaj të miturve nëse me Kodin e Drejtësisë për të Mitur nuk parashihet ndryshe.

Neni 3
Parandalimi i shkeljeve

1.Çdo i punësuar në institucionet korrektuese konsiderohet person përgjegjës në atë institucion korrektues i cili në rast të mosmarrëveshjeve ndërmejt të burgosurve përdorë mekanizmat parandalues për të zgjidhur mosmarrëveshjet me qëllim të parandalimit të shkeljeve të mundshme disiplinore.

2.Personi përgjegjës i paraparë në paragrafin 1 të këtij neni është i obliguar që të udhëhiqet nga parimi i paanshmërisë, barazisë së palëve në procedurë, fshehtësisë, besueshmërisë, si dhe vullnetit të tyre që mosmarrëveshjet që nuk përbëjnë shkelje disiplinore t'i zgjidhin me mirëkuptim.

3.Personi përgjegjës është i obliguar që të mbaj shënim zyrtar lidhur me rastet e parapara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni dhe për këtë e njofton udhëheqësin e pavijonit.

Neni 4
Klasifikimi i shkeljeve disiplinore

1.Shkeljet disiplinore klasifikohen në shkeljet e lehta dhe shkeljet e rënda.

2.Personi i dënuar kryen shkelje të lehtë disiplinore kur:

2.1.nuk e respekton urdhrin e arsyeshëm të anëtarit të personelit;

2.2.qëndron në zonë të ndaluar për personat e dënuar, pa leje;

2.3.manifeston sjellje të pahijshme dhe fyen anëtarin e personelit;

2.4.manifeston sjellje të pahijshme dhe fyen cilindo person në mënyrë e cila mund të provokoj personin tjetër të jetë i dhunshëm;

2.5.refuzon apo i shmanget punës ose nuk paraqitet në punë pa ndonjë shkak të arsyeshëm;

2.6. merret me bixhoz;

2.7.me vetëdije nuk i respekton rregullat e shkruara, me të cilat rregullohet sjellja e personave të dënuar; ose

2.8. tenton të kryej apo t'i ndihmoj personit tjetër në kryerjen e ndonjërit prej veprimeve nga nënparagrafi 2.1 deri 2.7 të këtij paragrafi.

3. Personi i dënuar kryen shkelje të rëndë disiplinore nëse:

3.1.rrahë, sulmon, ose kërcnohet se do të sulmoj personin tjetër;

3.2.me vetëdije, apo nga pakujdesia e dëmton, ose e shkatrron pasurinë që nuk është e tij;

3.3.kryen vjedhje;

3.4.nëse posedon pasuri të vjedhur;

3.5.ofron, jep, ose merr ryshfet, apo shpërblim;

3.6.është në posedim, ose merret me sendin e palejuar;

3.7. pa leje konsumon narkotikë të rrezikshëm, substancë psikotrope apo alkool;

3.8. krijon, apo merr pjesë në ndonjë trazirë, ose në ndonjë aktivitet tjetër i cili mund të rrezikoj mbrojtjen dhe sigurinë në institucionin korrektues;

3.9. kryen veprime përgatitore me qëllim të arratisjes; dhe

3.10. ikë, ose largohet nga institucioni korrektues, ose pa leje nuk kthehet në të.

4. Përpos shkeljeve të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni Drejtori i Institucionit Korrektues ndaj të paraburgosurve zhvillon procedurë disiplinore për shkeljet disiplinore, si në vijim:

4.1.sulmin fizik ndaj të paraburgosurve të tjerë, ndaj punëtorëve të institucionit të paraburgimit ose personave të tjerë zyrtar;

4.2.prodhimin, pranimin ose futjen e sendeve për sulm ose arratisje;

4.3.prodhimin ose futjen e pijeve alkoolike dhe narkotikëve dhe shpërndarjen e tyre;

4.4.shkeljen e rregullave për mbrojtjen në punë, mbrojtjen nga zjarri dhe parandalimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore;

4.5.përsëritjen e shkeljes së rendit shtëpiak të institucionit të paraburgimit;

4.6. shkaktimin e qëllimshëm të dëmit të madh material ose nga pakujdesia e rëndë;

4.7. sjelljen fyese dhe të padenjë.

Neni 5

Matja e dënimit

1.Me rastin e shqiptimit të dënimit disiplinor duhet të merren parasysh por pa u kufizuar vetëm në rrethanat e mëposhtme:

1.1.shkalla e përgjegjësisë;

1.2.motivet;

1.3.intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur;

1.4.rrethanat në të cilat është kryer;

1.5 sjellja e mëparshme;

1.6.pranimi i fajit;

1.7.bashkëpunimi;

1.8.gjendja shëndetësore;

1.9.rrethanat personale dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës.

2.Dënimi disiplinor duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen e tij, si dhe rrethanat e kryesit.

Neni 6

Llojet e dënimeve disiplinore për shkelje të lehtë

1.Llojet e dënimeve disiplinore që mund të shqiptohen ndaj të burgosurit për shkelje të lehtë disiplinore janë:

1.1.qortimi;

1.2. heqja e beneficionit të caktuar deri në dyzetepesë (45) ditë, dhe

1.3.urdhëri për kompensim.

Neni 7

Llojet e dënimeve disiplinore për shkelje te rënda

1. Llojet e dënimeve disiplinore që mund të shqiptohen ndaj personit të dënuar për shkelje të rëndë janë:

1.1.heqja e beneficinit të caktuar deri në gjashtë (6) muaj;|

1.2.urdhëri për kompensim nga llogaria e tij bankare në vlerë jo më të lartë se njëqind 100 euro;

1.3.vetmia për një periudhë jo më të gjatë se pesëmbdhjetë (15) ditë për secilën shkelje disiplinore;

1.4. vetmia për një periudhë jo me shumë se 30 ditë si dënim unik disiplinor për shkelje disiplinore në bashkim;

1.5. Në rast të shqiptimit të dënimit unik disiplinor që kalon priudhën prej 15 ditë, ndërpritet ekzekutimi i masës së vetmisë për një periudhe jo më pak se pesë (5) ditë dhe jo me shumë se dhjetë (10) ditë dhe pas kësaj ndërprerje vazhdon ekzekutimi i pjesës së mbetur të vetmisë.

2.Periudha e përgjithshme e vetmisë së personit të dënuar të shqiptuar si dënim të vetëm dhe si dënim unik disiplinor nuk mund të jetë më e gjatë se 60 ditë gjatë një viti kalendarik.

Neni 8

Kompetenca për shqiptimin e masës disiplinore

1.Masat disiplinore për shkeljet e lehta shqiptohen nga mbikëqyrësi i lartë kujdestar në institucionin korrektues.

2.Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga Drejtori i Institucionit Korrektues pas pranimit të rekomandimeve të panelit disiplinor.

Neni 9

Fillimi dhe zhvillimi i procedurës disiplinore

1.Çdo i punësuar në insitucionin korrektues është i obliguar që menjëherë pas njoftimit të paraqes shkeljen disiplinore të cilën e ka kryer i burgosuri.

2.I dënuari i cili pretendon se është i dëmtuar mund të paraqes rastin me shkrim ose gojarisht në procesverbal para personit zyrtar për fillimin e procedurës disiplinore.

3.Çdo person zyrtar që pranon informacione sipas paragrafit 2 të këtij neni mban procesverbal i cili nënshkruhet nga të dy palët.

4.Personat tjerë të cilët kanë informacione për rastin mund ta paraqesin atë tek personi përgjegjës i institucionit korrektues.

5.Në rastin e veprimit urgjent lidhur me shkeljen disiplinore, për shkak të grumbullimit dhe sigurimit të provave, si dhe me qëllim të pengimit të krijimit të pasojave të mëtejme të

dëmshme, paraqitësi i rastit menjihërë e njofton udhëheqësin e pavijonit të institucionit korrektues lidhur me rastin.

6.Nëse vlerësohet se për shkak të incidentit i dënuari ka pësuar lëndim trupor, pa vonesë njoftohet personeli mjekësor i institucionit. Personeli mjekësor pas trajtimit të të dënuarit e përpilon raportin me të cilin njoftohet udhëheqësi i pavijonit.

7.Shkelja disiplinore fillon të hetohet në afatin prej tre (3) ditëve nga momenti i marrjes së informacionit.

8.Gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore, personat e autorizuar me ligj mund të ndihmohen edhe nga personeli tjetër profesional me qëllim të konstatimit dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike. Zbatimi i procedurës disiplinore duhet të jetë i paanshëm dhe objektiv, duke i kushtuar kujdes të veçantë natyrës dhe shkallës së seriozitetit të shkeljes.

9.Nëse gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj të burgosurit, ekziston dyshimi i bazuar për vepër penale në të cilën është i përfshirë personeli i institucionit, rasti do të procedohet në prokurorinë kompetente.

10.Shqyrtimi i secilës çështje disiplinore ndaj personit të burgosur duhet bëhet brenda afatit ligjor, qoftë duke i shqiptuar dënimin disiplinor apo duke e liruar nga përgjegjësia bazuar në faktet dhe provat e administruara.

11.Shkelja disiplinore trajtohet në institucionin korrektues në të cilin personi i burgosur është i vendosur. Përjashtimisht, procedura mund të zhvillohet edhe në ambient tjetër kur këtë e kërkojnë rrethanat e rastit. Nëse shkelja disiplinore është kryer nga një i burgosur gjatë transferimit, rasti do të trajtohet në institucionin korrektues në të cilin i dënuari do të vendoset.

12.Pas përfundimit të procedurës disiplinore, personi i burgosur i cili ka qenë i dyshuar për shkelje disiplinore, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me përfundimin e kësaj çështje dhe e njëjta vendoset në dosjen personale të të burgosurit.

Neni 10

Vendosja e çështjes në procedurë disiplinore

1.Mbikëqyrësi i lartë kujdestar në institucionin korrektues në rastet e shkeljes së lehtë disiplinore, fillon procedurën disiplinore brenda afatit prej tre (3) ditëve nga njoftimi lidhur me rastin, pas shqyrtimit të fakteve dhe intervistimit të palëve në procedurë nxjerr vendim lidhur me masën disiplinore brenda afatit prej shtatë (7) ditëve.

2. Në rastet e shkeljes së rëndë disiplinore, Drejtori i Institucionit Korrektues fillon procedurën disiplinore brenda afatit prej tre (3) ditëve nga njoftimi lidhur me përgjegjësinë disiplinore dhe nxjerr vendim brenda afatit prej pesëmbdhjetë (15) ditëve.

Neni 11

Përjashtimi nga shqyrtimi i çështjes

1.Në të gjitha rastet e parapara në nenin 9 të këtij Udhëzimi Administrativ, kur personat e autorizuar me ligj, të cilët zhvillojnë procedurën disiplinore kanë konflikt interesi, apo në çfardo forme vihet në pyetje objektiviteti i tij, atëherë ai duhet të përjashtohet.

2.Vendimin për përjashtimin e mbikëqyrësit të lartë kujdestar të institucionit korrektues nga zbatimi i procedurës disiplinore në rastet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni e nxjerr Drejtori i Institucionit Korrektues.

3. Vendimin për përjashtimin e Drejtorit të Institucionit Korrektues nga zhvillimi i procedurës disiplinore në rastet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni e nxjerr Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues.

4. Personat të cilët zhvillojnë procedurën disiplinore, e gjithashtu edhe palët e përfshira në procedure në rast të konfliktit të mundshëm të interesit mund të kërkojnë përjashtimin e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.

5.Lidhur me përjashtimin duhet të vendoset brenda afatit prej pesë (5) ditëve nga momenti i paraqitjes së kërkesës për përjashtim.

Neni 12

Themelimi dhe puna e Panelit Disiplinor

1.Për shkeljet e rënda disiplinore të parapara në këtë Udhëzimi Administrativ, Drejtori i Institucionit Korrektues themelon Panel Disiplinor ad hoc.

2. Paneli disiplinor i paraparë në paragrafin 1 të këtij Udhëzimi Administrativ përbëhet nga tre (3) anëtar, të cilët janë pjesë e personelit të institucioneve korrektuese varësisht nga rasti.

3.Paneli disiplinor mbledhë, shqyrton faktet dhe provat, interviston personat e burgosur dhe personelin dhe brenda afatit prej pesë (5) ditëve harton raportin me rekomandime lidhur me përgjegjësin disiplinore të burgosurit dhe të njëjtin e dorëzon te drejtori i institucionit korrektues.

4.I burgosuri njoftohet lidhur me shkeljen të cilën dyshohet se e ka kryer, duke ia ofruar të gjitha faktet dhe provat të cilat e ngarkojnë, me përjashtim të atyre provave të cilat drejtori i institucionit korrektues vlerëson se zbulimi i tyre rrezikon jetën e njerëzve dhe sigurinë në institucionet korrektuese.

5.Me qëllim të përgatitjes së mbrojtjes, i dënuari njoftohet para mbajtjes së seancës dëgjimore lidhur me shkeljen disiplinore të supozuar duke ia ofruar faktet dhe provat të cilat e ngarkojnë, përjashtimisht materialeve që konsiderohen konfidenciale. i dënuari ka të drejtë që të ofroj prova si dhe të propozoj dëgjimin e dëshmitarëve për ta mbështetur qëndrimin e tij.

Neni 13

Seanca dëgjimore

1.Paneli cakton seancën dëgjimore ku ftohet personi i dënuar në cilësinë e të dyshuarit, të dënuarit tjerë në cilësinë e dëshmitarit dhe personeli i institucionit korrektues që kanë njohuri për rastin.

2. I burgosuri për mos pjesëmarrje në seancë dëgjimor njofton me shkrim panelin.

3. I burgosuri njoftohet se nëse nuk merr pjesë në seancë dhe mungesën e tij nuk e arsyeton, seanca do të mbahet edhe në mungesë të tij. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore mbahet procesverbal.

4. Drejtori i Institucionit Korrektues pas pranimet te raportit me rekomandime nga paneli merr vendim lidhur me përgjegjësinë disiplinore dhe të njëjtin ia dërgon të burgosurit.

Neni 14 **Parashkrimi i afatit për fillimin e procedurës disiplinore**

1. Afati i parashkrimit të shkeljes disiplinore fillon nga dita kur është kryer shkelja.

2. Procedura disiplinore nuk mund të filloj nëse kanë kaluar afatet kohore si në vijim:

2.1. tre (3) muaj nga njoftimi për shkeljen, por jo më shumë se gjashtë (6) muaj nga kryerja e shkeljes së lehtë disiplinore të supozuar.

2.2. gjashtë (6) muaj nga njoftimi për shkeljen, por jo më shumë se një (1) vit nga kryerja e shkeljes së rëndë disiplinore të supozuar.

3. Zyrtari përgjegjës i cili zhvillon procedurën disiplinore në rastet e parashkrimit nga paragrafi 2.1 dhe 2.2 nxjerr vendim për përfundimin e procedurës dhe njoftohet i burgosuri.

Neni 15 **E drejta e ankesës**

1. Kundër vendimit për shqiptimin e dënimit disiplinor për shkelje të lehta, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese te Drejtori i Institucionit brenda afati prej tre (3) ditësh nga dita e pranimet të vendimit.

2. Kundër vendimit për shqiptimin e dënim disiplinor për shkelje të rëndë, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese te Drejtori i Përgjithshëm brenda afati prej tre (3) dite nga dita e pranimet të vendimit.

3. Kundër vendimit për shqiptimin e masës disiplinore për të paraburgosurit ndalim ose kufizim të vizitave ose korrespondenca mund të paraqitet ankese brenda 24 orëve tek gjyqtari kompetent, ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.

4. Në rastet kur i dënuari të cilit i është shqiptuar dënim disiplinor është i pakënaqur me vendimin, por që nuk dinë shkrim dhe lexim, apo për shkaqe tjera të arsyeshme nuk është në gjendje të ushtroj ankese, atëherë ankesa e tij përpilohet nga zyrtari përgjegjës i institucionit korrektues dhe procedohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 16 **Mbajtja e evidencave**

Institucioni korrektues mban evidencë për procedurat disiplinore dhe për dënimet disiplinore të shqiptuara ndaj të dënuarve brenda institucionit korrektues.

Neni 17 **Shuarja e masave disiplinore**

1. Masa disiplinore e shqiptuar ndaj të burgosurve shuhet pas kalimit afateve, si në vijim:

1.1. masa disiplinore e shqiptuar për shkelje të lehta disiplinore shuhet pas kalimit të afatit gjashtë (6) muaj;

1.2. masa disiplinore e shqiptuar për shkelje të rëndë disiplinore shuhet pas kalimit të afatit prej një (1) viti.

Neni 18 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ për Procedurat Disiplinore dhe Masat për të Burgosurit në Institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës nr. 02/2016, i datës 28.09.2016.

Neni 19 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

05/12/2024